



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:093617

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06748952

P.nr.111/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit V H, nga fshati Z K.K, për shkak të veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.366/2024 të datës 21.06.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me dt.08.01.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala i pandehuri V H dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyres zyrtare av. Gani Morina, me dt.08.01.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.01.2025, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V H nga i ati Xh e ëma S e gjinisë G, i lindur me datë në fshatin Z, ku dhe tani banon, me nr.personal:, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, me profesion murator, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Pasi më parë ka siguruar e gjerë me datë 23.02.2024, rreth orës 09:30, në fshatin Zë, Komuna e K, pikërisht në shtëpinë e tij, i pandehuri në kundërshtim me ligjin e

aplikueshëm për armët të republikës së Kosovës nr.05/L-022, pa autorizim ka mbajtur pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armën , e cila me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara , dhe atë një 1 pushkë gjuetie markës Moseberg model Patriot nr.serik prodhimit amerikan , fishek të kal mm, një pushkë gjuetie markës cifsan model nr.serik prodhimit turk 8 tetë fishek të kal. dhjetë fishek kal.mm, 1një fishekë kal. mm, në atë mënyrë që gjatë ekzaminimit të vendit të ngjarjes nga policia lidhur me rastin e vjedhjes në shtëpinë e tani të pandehurit në katin e dytë përkatësisht në dhomat e gjumit janë gjetur armët dhe municioni për të cilat në bazë të lejes për armë gjahu lëshuar me datë10.11.2017 leja për armën të markës M kishte skaduar që nga data 10.11.2022, ndërsa në bazë të lejes për armë gjahu lëshuar me dt.04.01.2019 leja për armë gjahu të markës cifsan kishte skaduar që nga data 01.01.2024, me ç, rast armët së bashku me fishekët janë konfiskuar nga ana e policisë.

me çka ka kryer veprë penale, Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7 , 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69,70 dhe neni 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe neni 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPRK-së:

GJYKON
DËNIM ME GJOBË

I.Të pandehurin V H, e dënon me dënim me gjobë shuma në vlerë prej pesëqind (500) Euro, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj brenda afati kohor në kohë zgjatje prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform neni 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës.

III.OBLIGOHET: I pandehuri qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, si dhe tarifën për kompenzim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

IV. Konfiskohe: Konform neni 366 par. 3 një 1 pushkë gjuetie markës M model Patriot nr.serik prodhimit amerikan, 21 fishek të kal 308 mm, dhe një 1 pushkë gjuetie markës

prodhimit turk 8 tetë fishek të kal. fishek kalmm, 1një fishekë kal.mm, njëjtat të shkatërrohen pas pranimit të raportit të ekspertizës balistike.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.847/2024 e datës 24.06.2024, kundër të pandehurit V H nga fshati Z-K.K, ku dhe tani banon, për shkak të veprës penale; Mbajtja në pronësi, kontroll posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së.

Gjykata me datë 08.01.2025, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i pandehuri V H dhe si dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Gani Morina.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.08.01.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri V H pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij av.Gani Morina, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë, më vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaron se shpreh pendesë për veprat e penale të kryera, po ashtu deklaron se në kohën kur është dashur, që të bëjë vazhdimin lejes për armën, kam qenë i sëmurë dhe nuk kam pas mundësi që të vie, pasi që jetoj qe 8 vite në Gjermani dhe kjo është e tërë arsyeja se po të kisha mundësi do të vijë. I premtoj Gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjajshme penale, po ashtu kërkoj falje publike në këtë seancë.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av.Gani Morina, ka deklaruar se; pas konsultimeve me të mbrojturin tim V H dhe shpjegimi për mundësin e pranimit apo mospranimit të fajësis, i njëjti pa kurrfarë kërcënimi apo ndikimi ka vendos që të pranon fajësin , prandaj une e mbështes pranimin e fajësis dhe lus gjykatën që pas marrjes së

vendimit për dënimin të ketë parasysh gjendjen e tij të dobët financiare se asnjëri nga familjarët nuk është në marrëdhënje pune se vet i pandehuri punon vetëm veres si punëtor fizik dhe me ato mjete të siguruara kujdeset sado pak për familjen e sidomos për nënen e vet e cila ka vuajtur dhe vuan nga një sëmundje të eshtrave dhe sot e njëjta gjendet në kontrollin e mjekëve. Prandaj e lus gjykatën që të pranoj fajësin pranimin e fajësis dhe mbi bazën e nenit 71 të KPRK-së, të pandehurit të i shqiptoj një dënim sa më të butë, e sidomos për faktin se i njëjti edhe tani gjendet në marrëdhënje të punës.

Deklarimi i palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që të merr parasysh intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

Edhe mbrojtësi i të pandehurit av. Gani Morina është deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësis mbështetet në provat materiale, të cilat mbështesin aktakuzën, si : Raporti i Fillestar i incidentit nr.2024-DE-073 i dt.23.02.2024 nga R #0056, Shënim zyrtar nr.2024-DE-073 i dt.23.02.2024 RG #0056, Raporti policor hetues nr.2024-de-073 i dt.23.02.2024 rrahman gashi #0056, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të konfiskuara nga oficeri avni Krasniqi #3337 të dt.23.02.2024, deklarata e të

pandehurit dhënë në polici i dt.24.02.2024 dhe në Prokurori i dt.21.06.2024 si dhe foto albumi dhe fotot e armëve dhe fishekëve të sekuestruar.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Bazuar në të lartëcekurat gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprën penale , në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen,, Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesë qind (7.500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet ,..

Andaj bazuar në të lartëcekura, Gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale,, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedimi i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së , nga se veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së duke e vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, padënueshmërinë e tij më parë, sjelljen e mirë pas kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësis penale.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerje e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Konfiskimin e armës nga gjykata është bazuar në nenin 366 par.3 ku është përcaktuar se dy armët të konfiskohen dhe të shkatërrohen.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par.2.6 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartëcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.111/2024 me datë 23.01.2025

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

Bashkëpunëtorja profesionale

Fatmire Elezaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.